



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10
Prokurorja e Specializuar kundër Sabit Januzit,
Ismet Bahtjarit dhe Haxhi Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 5 qershor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Sabit Januzit

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Zyrës Administrative

Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Ismet Bahtjarit

Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës

Tobi Kadman

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 tetor 2023, Sabit Januzi (“z. Januzi” ose “i akuzuari”) u arrestua në bazë të vendimit² dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,³ me kërkesë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),⁴ dhe në vijim të konfirmimit të Aktakuzës kundër tij dhe Ismet Bahtijarit (“z. Bahtijari” dhe “Vendimi i Konfirmimit”).⁵

2. Më 8 dhjetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën për lirim të përkohshëm të dorëzuar nga Mbrojtja e z. Januzi (“Mbrojtja”) dhe

¹ KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik. KSC-BC-2023-11, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 20 nëntor 2023, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00009, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave të Transferimit*, (“Vendimi për Arrestimin”), 2 tetor 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-4, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më 12 tetor 2023, F00009/RED.

³ *Shih* KSC-BC-2023-10, F00009/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për Sabit Januzin*, 2 tetor 2023, konfidencial; versioni i redaktuar publik u lëshua më 28 shkurt 2024, F00009/RED/A01/RED; F00012, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Sabit Januzit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, publik.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00002, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të*, 11 shtator 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 32(ii), me Shtojcat 1 dhe 3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzuan më 12 tetor 2023, F00002/CONF/RED dhe F00002/RED.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 2 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzuan më 12 tetor 2023, F00008/CONF/RED dhe F00008/RED. Versioni i korrigjuar i versionit të redaktuar publik të vendimit u dorëzua më 12 tetor 2023, F00008/RED/COR.

urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Januzi (“Vendimi i Parë për Paraburgimin”).⁶

3. Më 20 dhjetor 2023, z. Januzi dorëzoi apelin kundër Vendimit të Parë për Paraburgimin.⁷ Më 5 shkurt 2024, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelin.⁸

4. Më 8 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bashkoi çështjen gjyqësore kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari, me çështjen gjyqësore kundër Haxhi Shalës (“z. Shala”).⁹ Po atë ditë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rishikoi paraburgimin e z. Januzi dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij (“Vendimi i Dytë për Paraburgimin”).¹⁰

5. Më 27 mars 2024, Gjykatësi i Procedurës paraprake lëshoi vendimin ku, ndër të tjera, përcaktoi kalendarin për hapat e mbetur proceduralë, përfshirë datën për kalimin e çështjes gjyqësore Trupit Gjykues më 21 qershor 2024.¹¹

6. Më 8 prill 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rishikoi paraburgimin e z. Januzi dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij (“Vendimi i Tretë për Paraburgimin”).¹²

⁶ KSC-BC-2023-10, F00123, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Sabit Januzit për Lirim të Përkohshëm*, 8 dhjetor 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 janar 2024, F00123/RED.

⁷ KSC-BC-2023-10, IA001/F00001/RED, Mbrojtja e z. Januzi, *Version i Redaktuar Publik i Apelit në Emër të Sabit Januzit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm*, 20 dhjetor 2023, publik.

⁸ KSC-BC-2023-10, IA001/F00007/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Sabit Januzit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm*, 5 shkurt 2024, publik.

⁹ KSC-BC-2023-10, F00161, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkim të Çështjeve dhe Ndryshim të Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial; versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F00161/RED; KSC-BC-2023-11, F00041, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkim të Çështjeve dhe Ndryshim të Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial; versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F00041/RED.

¹⁰ KSC-BC-2023-10, F00162, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Sabit Januzit*, 8 shkurt 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F00162/RED.

¹¹ KSC-BC-2023-10, F00233, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim që Përcakton Kalendarin për Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së Procedurës Paraprake* (“Vendimi mbi Kalendarin”), 27 mars 2024, publik, para. 30(k).

¹² KSC-BC-2023-10, F00245, , Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Sabit Januzit*, 8 prill 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F00245/RED.

7. Më 15 maj 2024, në bazë të urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,¹³ ZPS-ja dorëzoi parashtrimet e veta në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të z. Januzi ("Parashtrimet e ZPS-së").¹⁴ Mbrojtja e z. Januzi nuk paraqiti përgjigje.

II. PARASHTRIMET

8. ZPS-ja parashtron se paraburgimi i z. Januzi vazhdon të jetë i përligjur i domosdoshëm, i arsyeshëm dhe proporcional, pasi nuk ka pasur ndryshim të rrethanave që arsyetojnë devijimin nga konstatimet e bëra nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në Vendimin e Tretë mbi Paraburgimin.¹⁵ Në veçanti, ZPS-ja parashtron se nxjerrja në vijimësi e materialeve dhe ecuria e pandryshuar e çështjes gjyqësore i mundëson z. Januzi qasje në informacion të ndjeshëm, përforcojnë domosdoshmërinë dhe arsyeshmërinë e mbajtjes së tij në paraburgim.¹⁶

9. Sipas ZPS-së, vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Januzi ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të DHS-së¹⁷ dhe se vazhdojnë të vlejné arsyet për paraburgimin e tij sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.¹⁸ ZPS-ja parashtron më tej se (i) asnjë modalitet për lirim me kusht nuk ul mjaftueshëm rreziqet ekzistuese;¹⁹ dhe (ii) paraburgimi i tij vazhdon të jetë i arsyeshëm dhe proporcional meqë ecuria e procesit vazhdon me shpejtësi.²⁰ Bazuar në sa më lart, ZPS-ja parashtron se z. Januzi duhet të mbahet në paraburgim.²¹

¹³ Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 44(c).

¹⁴ KSC-BC-2023-10, F00290, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Sabit Januzit*, 15 maj 2024, publik.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 7-8, 21, 23.

¹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 7.

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 8.

¹⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9-16.

¹⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 17-21.

²⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 22-25.

²¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 26.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Sipas nenit 41(6) të Ligjit, Dhomat e Specializuara ("DHS") urdhërojnë paraburgimin e një personi vetëm: (a) kur ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer një vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së; dhe (b) kur ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një veprë penale, ose do të pengojë ecurinë e procedurës penale duke ndikuar tek dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryerësit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

11. Sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formë të prerë ose deri në lirim nga paraburgimi, me kalimin e 2 (dy) muajve nga vendimi i fundit mbi paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen, shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

12. Sipas nenit 41(12) të Ligjit, krahas masës së paraburgimit, për të siguruar praninë e të akuzuarit, përfshirë nëpërmjet videokonferencës, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, ose për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procesit penal, DHS-ja mund të urdhërojë masat në vijim: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në ndonjë vend tjetër dhe masat shmangëse.

13. Sipas rregullës 56(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes, dhe në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar

nga Prokurori i Specializuar, trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve, mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI I ZBATUESHËM

14. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në bazë të nenit 41(10) të Ligjit, ai ka detyrimin të shqyrtojë nëse ekzistojnë ende arsytet për mbajtje në paraburgim,²² përfshirë arsytet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht (i) nëse ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer veprën ose veprat penale; dhe (ii) nëse ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston ndonjë prej rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.²³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk është i detyruar të bëjë konstatime në lidhje me faktorët për të cilët tashmë është vendosur në vendimin e parë për paraburgimin, e as të shqyrtojë parashtrime që thjesht përsërisin argumente tashmë të trajtuara në vendime të mëparshme.²⁴ Është thelbësore që, në kohën e rishikimit të vendimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake të bindet se ende ekzistojnë arsytet për vazhdimin e paraburgimit.²⁵

²² *Shih, për shembull*, KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi i Parë i Apelit për Paraburgimin e Haradinajt"), 9 shkurt 2021, publik, para. 55; KSC-BC-2020-06, IA006/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit ndaj Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, ("Vendimi i Dytë i Apelit për Paraburgimin e Krasniqit"), 1 tetor 2021, publik, para. 15. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-04, F00224/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës* ("Vendimi i Gjashtë për Paraburgimin e Shalës"), 22 qershor 2022, publik, para. 19.

²³ *Shih për shembull*, Vendimin e Gjashtë për Paraburgimin e Shalës, para. 19; KSC-BC-2020-04, F00075/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 shtator 2021, publik, para. 19; KSC-BC-2020-07, F00143, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 24 shkurt 2021, publik, para. 17.

²⁴ Vendimi i Parë i Apelit për Paraburgimin e Haradinajt, para. 55; Vendimi i Dytë i Apelit për Paraburgimin e Krasniqit, para. 17; Vendimi i Gjashtë për Paraburgimin e Shalës, para. 19.

²⁵ Vendimi i Parë i Apelit për Paraburgimin e Haradinajt, para. 55.

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake po kështu nënvizon se, në çdo analizë të paraburgimit të z. Januzi, duhet të merret parasysh në masën e duhur prezumimi i pafajësisë së tij.²⁶ Kjo, për pasojë, do të thotë se për vazhdimin e paraburgimit nuk mund të vendoset me lehtësi, dhe se ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.²⁷

B. DYSHIMI I BAZUAR

16. Sa i përket standardit lidhur me vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit së pari kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer veprë penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së. Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të të paraburgosurit.²⁸

17. ZPS-ja parashtron se konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake për ekzistencën e dyshimit të bazuar është ende i vlefshëm, dhe se, që nga Vendimi i Konfirmimit, nuk ka pasur zhvillime të reja që mund të cenojnë këtë konstatim të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.²⁹ Sipas ZPS-së, konstatimet në fjalë vetëm se janë përforcuar.³⁰

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në Vendimin e Konfirmimit, u përcaktua se, sipas nenit 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Januzi është penalisht përgjegjës për vepra penale që përfshihen në juridiksionin

²⁶ KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* ("Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 prillit 2017"), 26 prill 2017, publik, para. 113; KSC-BC-2020-06, IA004/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 17, me referenca të mëtejshme. *Shih, ngjashëm* ECtHR, *McKay v. the United Kingdom*, no. 543/03, Judgment, 3 October 2006, para. 43.

²⁷ *Shih, ngjashëm*, Vendimin e Parë për Paraburgimin, para. 20; Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 12; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 13.

²⁸ KSC-BC-2020-04, F00045/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm* ("Vendimi i Parë për Paraburgimin e Shalës"), 15 qershor 2021, publik, para. 14. *Shih gjithashtu* ECtHR, *Merabishvili v. Georgia*, no. 72508/13, Judgment, 28 November 2017, para. 222.

²⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 8.

³⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 8.

e DHS-së, konkretisht për frikësim gjatë procedurës penale dhe pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas neneve 387 dhe 401(1), (2) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074 ("KPK") dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.³¹ Standardi mbi të cilin u bazuan këto konstatime ishte më i lartë se sa ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.³² Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në këtë çështje gjyqësore nuk ka pasur zhvillime që shfuqizojnë këto konstatime.³³

19. Rrjedhimisht, në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi që provon të kundërtën, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Januzi ka kryer veprat penale të përfshira në juridiksionin lëndor të DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) dhe (10) të Ligjit.

C. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

20. Pas përmbushjes së standardit të nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që përlligjin heqjen e lirisë së personit duhet të jenë të artikulueshme, në kuptimin që duhet të specifikohen me hollësi.³⁴ Në këtë aspekt, neni 41(6)(b) i Ligjit pasqyron parimin se vazhdimi i paraburgimit të një personi mund të përlligjet vetëm kur ka tregues konkretë të kushti të njëmendtë me interes publik, që peshon më shumë se e drejta për liri e personit.³⁵ Rrjedhimisht, kur merr vendimin për vazhdimin e

³¹ Vendimi i Konfirmimit, para 95, 111, 123, 126, 131, 135, 139, 144. *Shih gjithashtu* Vendimin për Arrestimin, para. 17.

³² Vendimi i Konfirmimit, para. 24.

³³ *Shih, ngjashëm*, Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 15; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 16.

³⁴ *Shih* nenin 19(1.31)) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2022, Kodi nr. 08/L-032, që e përkufizon kështu termin "i artikulueshëm: pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë informatën apo provën në të cilën mbështetet". *Shih gjithashtu*, për shembull, Vendimin e Parë për Paraburgimin e Shalës, para. 16; KSC-BC-2020-06, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 18-19.

³⁵ Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 prillit 2017, para. 113.

paraburgimit, trupi gjykues duhet të mbështetet në arsyetime të bazuara në çështjen dhe arsye konkrete.³⁶

21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton se, bazuar në provat e disponueshme, arsyet konkrete të artikuleshme duhet të mbështesin “besimin”³⁷ se ekziston ndonjë prej rreziqeve të parapara në tre nënparagrafët e nenit 41(6)(b) të Ligjit, çka nënkupton pranimin e mundësisë, e jo të pashmangshmërisë, se ato mund të ndodhin në të ardhmen.³⁸ Me fjalë të tjera, standardi që duhet zbatuar është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet.³⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vëren se këto arsye janë alternative, dhe se mjafton ekzistenca e një arsyeje për të vërtetuar domosdoshmërinë e paraburgimit.⁴⁰

22. Sa i përket llojit të vlerësimit sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, ndonëse përfshin një element të kompetencës diskrecionale,⁴¹ vlerësimi duhet të mbështetet në faktet e çështjes dhe duhet të kryhet mbi bazë individuale, duke mbajtur parasysh rrethanat personale të personit të paraburgosur.⁴² Kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson faktorët

³⁶ *Shih, ngjashëm*, Vendimin e Parë për Paraburgimin, para. 32; Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 17; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 18, me referenca të mëtejshme.

³⁷ *Shih* elementet kryesore të nenit 41(6)(b) të Ligjit.

³⁸ KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykues I, *Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit*, 25 maj 2021, publik, para. 17, me referenca të mëtejshme.

³⁹ Vendimi mbi Apelin e Thaçit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, para. 22.

⁴⁰ Vendimi i Parë për Paraburgimin e Shalës, para. 20; KSC-BC-2020-06, F00177/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm* (“Vendimi i Parë për Paraburgimin e Thaçit”), 22 janar 2021, publik, para. 25, me referenca të mëtejshme. *Shih, ngjashëm*, Vendimin e Parë për Paraburgimin, para. 32; Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 18; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 19.

⁴¹ Vendimi i Parë lidhur me Lirimin e Përkohshëm të Thaçit, para. 21, me referenca të mëtejshme.

⁴² *Shih gjithashtu* Vendimin e Parë për Paraburgimin e Shalës, para. 17; Vendimin e Parë për Paraburgimin e Thaçit, para. 21, me referenca të mëtejshme. *Ngjashëm*, ECtHR, *Aleksanyan v. Russia*, no. 46468/06, Judgment, 22 December 2008, para. 179.

përkatës, ai nuk i vlerëson ata në mënyrë fragmentare, por peshon të gjithë faktorët relevantë të marrë së bashku.⁴³

23. Së fundi, në lidhje me arsyet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, mjafton që rreziqet të mund të materializohen si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të personit të paraburgosur, por nuk është e nevojshme që ato të kryhen fizikisht nga ai.⁴⁴

1. Rreziku i arratisjes

24. ZPS-ja kujton konstatimin e mëparshëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Vendimin e Tretë për Paraburgimin se z. Januzi paraqet rrezik të moderuar të arratisjes.⁴⁵ Sipas ZPS-së, nxjerrja e vazhdueshme e provave inkriminuese shtesë, së bashku me dijeninë e z. Januzi për kalimin e dosjes gjyqësore Trupit Gjykues më një datë të caktuar, shton rrezikun që z. Januzi të arratiset.⁴⁶

25. Sa i përket rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprak konstaton se shqyrtimet në vendimet e mëparshme janë ende relevante, konkretisht: (i) dijenia e z. Januzi për akuzat e rënda ndaj tij dhe dënimin e mundshëm në rast të shpalljes fajtor;⁴⁷ (ii) njohuria gjithnjë e më shumë me provat që mbështesin akuzat në fjalë, si rezultat i procesit të nxjerrjes në vijimësi të tyre;⁴⁸ (iii) mjetet e tij për t'u arratisur dhe mundësia për t'i ikur

⁴³ Vendimi i Parë për Paraburgimin e Thaçit, para. 21, me referenca të mëtejshme. *Shih, ngjashëm*, Vendimin e Parë për Paraburgimin, para. 33; Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 19; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 20.

⁴⁴ Vendimi i Parë për Paraburgimin e Shalës, para. 19; Vendimi i Parë për Paraburgimin e Thaçit, para. 24. *Shih, ngjashëm*, Vendimin e Parë për Paraburgimin, para. 38; Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 20; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 21.

⁴⁵ Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 25.

⁴⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 10.

⁴⁷ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 42-43; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 22; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 23.

⁴⁸ *Shih* Parashtrimet e ZPS-së, para. 4. Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh se, që nga Vendimi i Tretë për Paraburgimin, për Mbrojtjen janë nxjerrë paketa shtesë të materialeve.

drejtësisë,⁴⁹ dhe (iv) fakti që z. Januzi është i vetëdijshëm për kalimin e dosjes gjyqësore Trupit Gjykues në të ardhmen.⁵⁰ Për mendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, mundësia e një gjykimi ku do të përcaktohet fajësia ose pafajësia e z. Januzi, së bashku me dijeninë gjithnjë e më shumë për provat kundër tij, vazhdojnë të jenë faktorë të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut të arratisjes së z. Januzi.

26. Krahas kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vazhdon të jetë i mendimit se, pavarësisht se z. Januzi i ka rrënjët në vendbanimin e tij dhe bashkëpunimit të tij me ZPS-në pas arrestimit, këta faktorë të favorshëm vetëm ulin rrezikun e arratisjes, por nuk e eliminojnë atë.⁵¹

27. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni që provon të kundërtën, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se, në lidhje me z. Januzi, vazhdon të ekzistojë rreziku i arratisjes, edhe pse i moderuar.

2. Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

28. ZPS-ja parashtron se z. Januzi vazhdon të paraqesë rrezik të pengimit të procesit të DHS-së,⁵² dhe kujton konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Vendimin e Parë për Paraburgimin dhe Vendimin e Dytë për Paraburgimin.⁵³ ZPS-ja parashtron më tej se atmosfera e përgjithshme në Kosovë e frikës dhe frikësimit të dëshmitarëve është aspekt kyç për shqyrtimin e lirit me kusht, sikurse është pranuar dhe në kontekst të çështjeve gjyqësore të tjera.⁵⁴

⁴⁹ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 44-47; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para 22; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 23.

⁵⁰ *Shih më lart* para. 5. Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 23.

⁵¹ Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 48; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 23; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 24.

⁵² Parashtrimet e ZPS-së, para. 11.

⁵³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12.

⁵⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13-14, me referenca të mëtejshme.

29. Sa i përket rrezikut të pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se: (i) vazhdojnë të vlejné rrethanat e përcaktuara në vendimet e mëparshme,⁵⁵ veçanërisht duke marrë parasysh se z. Januzi ka më shumë qasje në informacion të ndjeshëm në lidhje me dëshmitarin si rezultat i procesit të nxjerrjes në vijimësi të materialeve; dhe (ii) Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk i është paraqitur asnjë informacion që do të shfuqizonte konstatimet në ato vendime.

30. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni që provon të kundërtën, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Januzi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

31. ZPS-ja parashtron se, duke pasur nxjerrjen e vazhdueshme të informacionit të ndjeshëm për dëshmitarët, rreziku që z. Januzi të kryejë krime të tjera detyron vazhdimin e paraburgimit të tij.⁵⁶

32. Sa i përket kryerjes së krimeve të tjera sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, në rrethanat e çështjes aktuale, faktorët në të cilët mbështetet rreziku i parë janë relevantë edhe për vlerësimin e këtij të fundit.⁵⁷

⁵⁵ *Shih* Vendimin e Parë për Paraburgimin, para. 53-58; Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 26-29; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 27-28.

⁵⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 16.

⁵⁷ Vendimi për Arrestimin, para. 22; Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 61; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 31; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 30. *Shih gjithashtu* Vendimin e Parë për Paraburgimin e Shalës, para. 39.

33. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni që provon të kundërtën, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Januzi të kryejë krime të tjera.

4. Përfundim

34. Si rezultat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ka arsye të artikulueshme për të besuar se z. Januzi mund të arratiset (edhe pse ky rrezik është i moderuar), të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së, ose të kryejë vepra penale të tjera, çka bën të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit të tij në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake më poshtë do të vlerësojë nëse këto rreziqe mund të zvogëlohen në masë të mjaftueshme me kushte për lirimin e tij.

D. LIRIMI ME KUSHT

35. ZPS-ja parashtron se asnjë modalitet i lirimit të përkohshëm nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese, të cilat, siç argumenton ajo, janë rritur si rezultat i avancimit të procesit dhe nxjerrjes së mëtejshme të materialeve në këtë çështje.⁵⁸ Sa i përket rrezikut të pengimit të procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera, ZPS-ja argumenton se: (i) që nga Vendimi i Tretë për Paraburgimin nuk ka pasur ndryshim të rrethanave që do të përlligjte një vlerësim të ndryshëm të kushteve;⁵⁹ dhe (ii) vazhdojnë të vlejné konstatimet e mëparshme të Gjykatësit të Procedurës Paraprake se rreziqet përkatëse mund të trajtohen në mënyrë të efektshme vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁶⁰

36. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës

⁵⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 21.

⁵⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 21.

⁶⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 17-20.

Paraprake duhet të shqyrtojë masa alternative për parandalimin e rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.⁶¹

37. Sa i përket rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimet e tij të mëhershme se kushtet e propozuara në lidhje me Vendimin e Parë për Paraburgimin janë të përshtatshme për të ulur mjaftueshëm këtë rrezik.⁶²

38. Megjithatë, sikurse është konstatuar në vendimet e mëparshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se asnjë nga këto kushte të propozuara nuk mund ta kufizojë aftësinë e të akuzuarit për të penguar procesin e DHS-së dhe për të kryer vepra penale të tjera.⁶³ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban veçanërisht parasysh faktin se i akuzuari ka mjete dhe mundësi për ta kontaktuar dëshmitarin 1, dhe ka të ngjarë të ketë qasje në rrjetet dhe burimet e lidhura me z. Shala, dhe anëtarë të lartë të tjerë të udhëheqjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Rrjedhimisht, në rast lirimi, z. Januzi do të kishte motivin, mjetet dhe mundësinë për të ushtruar trysni ndaj dëshmitarit 1 dhe familjes së tij, për ta bindur atë të mos marrë pjesë në procesin e DHS-së, ose për të manipuluar provat në ndonjë mënyrë tjetër.⁶⁴ Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, megjithëse rreziku i mesazheve dhe udhëzimeve të paligjshme nuk mund të eliminohet tërësisht, masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të marra në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundër vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarë të familjes dhe vizitorë të miratuar paraprakisht, me

⁶¹ Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar "masa alternative", shih Aktvendimin e DHSGJK-së të 26 prillit 2017, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova*, no. 23755/07, Judgment ("*Buzadji v. Moldova*"), 5 July 2016, para. 87; ECtHR, *Idalov v. Russia*, no. 5826/03, Judgment, 22 May 2012, para. 140.

⁶² Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 69. Shih gjithashtu Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 36; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 35.

⁶³ Shih Vendimin e Parë për Paraburgimin, para. 70-71; Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 37; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 36.

⁶⁴ Shih Vendimin e Parë për Paraburgimin, para. 70; Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 37; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 36.

qëllim zvogëlimin e rrezikut të pengimit të procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera.⁶⁵

39. Për të njëjtat arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nuk ekzistojnë kushte të tjera të arsyeshme të vëna nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake⁶⁶ për të zvogëluar në masën e duhur rreziqet ekzistuese.

40. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kushtet e propozuara për z. Januzi në lidhje me Vendimin e Parë për Paraburgimin mbeten të pamjaftueshme për të zvogëluar në masën e duhur rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit.

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

41. ZPS-ja parashtron se paraburgimi i z. Januzi vazhdon të jetë i arsyeshëm dhe proporcional.⁶⁷ Në mbështetje të këtij konstatimi, ZPS-ja argumenton se procesi po vazhdon të avancojë me shpejtësi, duke pasur parasysh se data për kalimin e dosjes gjyqësore Trupit Gjykses është caktuar për 21 qershor 2024.⁶⁸

42. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson rëndësinë e parimit të proporcionalitetit në përcaktimin e arsyeshmërisë së paraburgimit, sikurse pasqyrohet në rregullën 56(2) të Rregullores.⁶⁹ Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është një faktor që duhet të merret parasysh së bashku me shkallën e rreziqeve të përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, në mënyrë që, duke mbajtur parasysh të gjithë faktorët, të përcaktohet nëse vazhdimi i paraburgimit “ka pushuar së qeni i arsyeshëm” dhe personi duhet të lirohet.⁷⁰ Megjithatë, Gjykatësi

⁶⁵ *Shih, ngjashëm, KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit, (“Vendimi i Apelit lidhur me Paraburgimin e Thaçit”), 27 tetor 2021, publik, para. 68.*

⁶⁶ *KSC-BC-2020-06, IA017/F00011/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit, 5 prill 2022, publik, para. 51.*

⁶⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 22, 25.

⁶⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 24.

⁶⁹ *KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, publik, para. 72-73.*

⁷⁰ *Vendimi i Apelit për Paraburgimin e Thaçit, para. 49, me referenca të mëtejshme.*

i Procedurës Paraprake vëren se çështja nëse koha e kaluar në paraburgim është e arsyeshme, nuk mund të vlerësohet teorikisht. Vlerësimi nëse vazhdimi i mbajtjes në paraburgim është i arsyeshëm duhet të bëhet mbi bazën e fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe sipas veçorive të saj specifike.⁷¹

43. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton se: (i) z. Januzi ndodhet në paraburgim që nga arrestimi i tij më 5 tetor 2023; (ii) ndaj tij janë ngritur dy akuza për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për frikësim gjatë procedurës penale, për të cilat ai mund të dënohet përkatësisht me deri në pesë dhe dhjetë vjet burgim; (iii) rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me kushtet e propozuara për lirim, arrest shtëpiak e as me kushte të tjera shtesë; dhe (iv) të gjitha veprimet e nevojshme procedurale në lidhje me fazën paraprake të kësaj çështjeje gjyqësore kanë përfunduar, po përfundojnë, ose do të përfundojnë, me synim kalimin e çështjes për gjykim më 21 qershor 2024.⁷² Konkretisht, që nga Vendimi i Tretë për Paraburgimin, ZPS-ja (i) ka përfunduar hapat hetues dhe ka mbetur vetëm një pjesë e vogël e materialit që pritet të nxirret;⁷³ (ii) ka njoftuar Gjykatësin e Procedurës Paraprake për rezultatin e diskutimeve *inter partes* me tre të akuzuarit lidhur pikat juridike dhe faktike për të cilat pajtohen;⁷⁴ dhe (iii) ka nxjerrë 12 paketa shtesë të materialit, gjatë periudhës 18 prill 2024 deri 31 maj 2024.⁷⁵

⁷¹ ECtHR, *Buzadji v. Moldova*, para. 90. *Shih, ngjashëm*, Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 41; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 40.

⁷² Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 41. *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2023-10, F00306, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Ismet Bahtijarit*, 28 maj 2024, publik, para. 42.

⁷³ KSC-BC-2023-10, F00249, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrimet e Prokurorisë në lidhje me Përfundimin e Hetimeve*, 12 prill 2024, konfidencial; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 3 maj 2024, F00249/RED; F00260, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim i Hollësishëm i Prokurorisë në lidhje me Procesin e Nxjerrjes së Materialeve*, 19 prill 2024, publik.

⁷⁴ KSC-BC-2023-10, F00296, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim për Faktet dhe Pikat Juridike për të Cilat ka Pajtim*, 17 maj 2024, publik, me Shtojcat 1-2, konfidenciale.

⁷⁵ Paketat nr. 22-33 të Materialeve të Nxjerra.

44. Së fundi, në bazë të nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Januzi do të rishikohet çdo dy muaj, ose sapo të ketë ndryshim të rrethanave.

45. Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se z. Januzi nuk është mbajtur në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores.

V. VENDIM

46. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Januzi;
- b. **URDHËRON** z. Januzi që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri **të enjten, 11 korrik 2024**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe
- c. **URDHËRON** ZPS-në që, nëse z. Januzi vendos të mos paraqesë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Januzi deri **të enjten, 18 korrik 2024** dhe z. Januzi që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrimet e tij deri **të enjten, 25 korrik 2024**.

 /nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 5 qershor 2024

Në Hagë, Holandë.